

URDHËR
Nr.193, datë 20.3.2020

PËR MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(Ndryshuar me urdhrin nr. 208, datë 30.3.2020, nr. 255, datë 10.4.2020, nr. 256, datë 10.4.2020, nr. 278, datë 25.4.2020, nr. 286, datë 30.4.2020, nr. 301, datë 8.5.2020, nr. 302, datë 8.5.2020)

I përditësuar

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr.15/201, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. *Lejohen të kryejnë aktivitetin e tyre vetëm në fashën orare 05:00–17:30, duke filluar nga dita e hënë, datë 13.4.2020, pikat e shitjes së produkteve ushqimore, me pakicë dhe shumicë, pikat e tregtisë së barnave, produkteve mjekësore dhe institucionet financiare.*

1/1. Hyrja në aktivitetet e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri lejohet vetëm për një person, të autorizuar, për çdo familje, për kryerjen e shpenzimeve familjare ditore. Autorizimi do të jetë vetëm një herë në ditë dhe do të ketë një afat prej 2 (dy) orësh, gjatë fashës orare 05:00 deri në 17:30.

Hyrja në të gjitha dyqanet/njësitë tregtare që lejohet të hapen duhet të bëhet me radhë, duke ruajtur distancën e sigurisë prej 1.5 m nga njëri-tjetri. Çdo dyqan/njësi tregtare duhet të sigurojë maska dhe doreza për punonjësit gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe solucion dezinfektues për të gjithë personat që hyjnë në ambientet e dyqanit/njësisë tregtare.

2. *Kufizimin e lëvizjes, në të gjitha qendrat urbane të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha kategoritë (këmbësorë, biçikleta, ciklomotorë, motomjete dhe mjete) si dhe ndalimi i ofrimit të shërbimeve për qytetarët nga aktivitetet e lejuara, çdo fundjavë, duke filluar nga e premija ora 17:30 deri të hënën në orën 05:00. Përfshihen nga ky rregull të gjitha mjetet e transportit të mallrave dhe të produkteve ushqimore, Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, njësitë kritike të shërbimeve shtetërore dhe atyre të kompanive mediatike, si dhe shërbimet në banesë (delivery).*

3. *Ndalohet ofrimi i shërbimit ndaj qytetarëve nga të gjitha aktivitetet, përfshirë ato të përcaktuara në pikën 1, dhe në tabelën bashkëlidhur këtij urdhri, duke filluar nga e premija, datë 17.4.2020 e në vijim, nga ora 17:30 deri të hënën në orën 05:00, deri në një urdhër të dytë. Përfshihen nga ky rregull bëhet për pikat e shitjes së produkteve ushqimore me pakicë dhe farmacistë, të cilat ditën e shtunë, datë 9 maj 2020, lejohen të ushtrojnë aktivitetin e tyre deri në orën 17:30.*

Lista me aktivitetet e përcaktuara në tabelën bashkëlidhur këtij urdhri hyn në fuqi në orën 05:00 të datës 24.3.2020.

3/1 Lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre, bizneset e mbyllura sipas listës bashkëlidhur urdhrit nr. 193, datë 20.3.2020, “Për kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të kategorizuara me risk të ulët sipas listës bashkëlidhur këtij urdhri, duke filluar nga dita e hënë, datë 27.4.2020, e në vijim, në intervalin kohor prej orës 5:00, deri në orën 17:30. Këto aktivitete do të ushtrojnë veprimtarinë vetëm në bazë të protokolleve të miratuara në urdhrin nr. 266, datë 21.4.2020, “Për përcaktimin e kategorive të bizneseve sipas niveleve të riskut dhe miratimit të protokolleve të masave higjieno-sanitare dhe distancimit social për parandalimin e përhapjes së COVID-19”. Lejohet aktiviteti i taksive për lëvizje ndërqytetase deri në dy pasagjerë, anëtarë të së njëjtës familje, sipas protokolleve të miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik.

3/2 Lejohet të ushtrojnë veprimtarinë e tyre, bizneset e mbyllura sipas listës bashkëlidhur Urdhrit nr. 193, datë 20.3.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas tabelës. 1 bashkëlidhur këtij urdhri, duke filluar nga data 11 maj 2020, brenda fashës orare 08:00-17:30.

4. Punonjësit e institucioneve financiare, të linjave prodhuese e ushqimore, dhe të gjitha aktivitetet e lejuara, sipas tabelës bashkëlidhur këtij urdhri, do të lejohen të qarkullojnë vetëm për itinerarin shtëpi-punë.

5. Çdo rregull i përcaktuar nga urdhrat e mëparshëm, që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

(ndryshuar me urdhrin nr. 208, datë 30.3.2020)

46	Gomisteri	Lejohen
68	Tregtia me pakicë e librave në dyqane të specializuara	Lejohen
70	Shitje me pakicë për kancelari dhe pajisje të zyrës	Lejohen

(shtuar me urdhrin nr. 278, datë 25.4.2020)

Statusi	Klasa	Klasa _ Përshkrimi
Lejohen	4719	Shitje të tjera me pakicë në dyqane jo të specializuara.
Lejohen	4771	Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara.
Lejohen	4778	Shitje me pakicë të mallrave të tjera të reja në dyqane të specializuara.
Lejohen	4932	Aktiviteti i taksive.
Lejohen	4751	Tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara.
Lejohen	4772	Tregtia me pakicë e këpucëve dhe artikujve prej lëkure në dyqane të specializuara.
Lejohen	9609	Aktivitete të tjera p.k.t.
Lejohen	4759	Tregtia me pakicë e mobilieve, pajisjeve të ndriçimit dhe artikujve shtëpiakë në dyqane të specializuara p.k.t.
Lejohen	4776	Tregtia me pakicë e luleve, bimëve, farave, plehëruesve, kafshëve të shtëpisë dhe ushqimit të tyre në dyqane të specializuara.
Lejohen	4777	Tregtia me pakicë e orëve dhe bizhuterive në dyqane të specializuara.
Lejohen	4743	Tregtia me pakicë e pajisjeve audio dhe video në dyqane të specializuara.
Lejohen	5920	Regjistrimi i zërit dhe aktivitete të publikimit të muzikës.
Lejohen	4753	Tregtia me pakicë e qilimave, sixhadeve, veshjeve të mureve dhe dysHEMEVE në dyqane të specializuara.
Lejohen	4765	Tregtia me pakicë e lojërave dhe lodrave në dyqane të specializuara.

Lejohen	4763	Tregtia me pakicë e regjistruarve muzikorë dhe video në dyqane të specializuara.
Lejohen	4764	Tregtia me pakicë e pajisjeve sportive në dyqane të specializuara.
Lejohen	4742	Tregtia me pakicë e pajisjeve të telekomunikacionit në dyqane të specializuar/pajisjet e telekomunikacionit në dyqane të specializuara.

(shtuar me urdhrin nr. 301, datë 8.5.2020)

Tabela 1

KODI NVE 2 DIGIT	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	STATUSI I AKTIVITETIT
50	Qendra Tregtare (përfshijë baret,restorantet dhe aktivitetet e destinuara për argëtimin e fëmijëve dhe të rinjve)	Lejohen
136	Aktivitetet të tjera shërbimi (Trajtime estetike, mireqenie fizike, përfshijë palestra) Këtu përfshihen aktivitetet të trajtimit të flokut dhe trajtime të tjera të bukurisë, të detajuara sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike.	Lejohen